AREA
ALBANIA RENEWABLE ENERGY ASSOCIATION

**Nr. 1810/ 249 Prot.** **Tiranë, më 18.04.2025**

**DREJTUAR**: Enti Rregullator i Energjisë

**Z.Petrit Ahmeti**
*Kryetari i Bordit të ERE*

**Elton Radheshi**
*Sekretar i Pergjithshëm i ERE*

**OBJEKTI**: Në lidhje me vendimin e ERE-s për ndryshime në kontratën e PP me FTL sipas propozimit të bërë nga FTL

Të nderuar,

Jemi vënë në dijeni të vendimit të ERE nr 302, datë 30.12.2024 për shqyrtimin e propozimit të FTL sh.a. për draft "Marrëveshjen për blerjen e energjisë elektrike ndërmjet furnizuesit të tregut të lire sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë".

Në princip AREA mendon se kontrata me FTL duhet të jetë e pandryshueshme për periudhën 15 vjecare të vlefshmërisë së saj nëse të dyja palët nuk bien dakort për ndonjë ndryshim të propozuar nga palët.

Vlerësojmë që ERE nuk ka marrë parasysh të gjitha ndryshimet e propozuara.

Në lidhje me pikat që ERE ka vendosur për shqyrtim kemi këto vlerësime:

1-pika C e paragrafit hyrës e propozuar mund të qëndrojë.

2-Neni 4 i propozuar për ndryshimin e datës së dërgimit të parashikimit të prodhimit për vitin pasardhës është një kërkesë që nuk do të sillte një rezultat të mirë, pra një parashikim më të saktë se parashikimi i bërë në vlerësim të prodhimit vjetor deri në fund të Nëntorit dhe për këtë mendojmë se nuk duhet të ndryshojë.

3-Neni 5 që përmban dërgimin e njoftimit nga ana e PP për të dalë në treg të lirë brenda datës 1 Gusht e shohim si të papërshtatshme sepse në analizën që do të bëjnë prodhuesit për të marrë këtë vendim ka dy faktorë, cmimi i tregut dhe cmimi vjetor i ofruar nga FTL sipas vendimit të ERE që del në fund të vitit. Marrja e vendimit në mes të vitit e bën

vendimin e PP për të dalë në treg të lirë mision të pamundur. Për këtë kërkojmë që kjo pikë të mos ndryshojë dhe të ngelet si datë për informimin e daljes në treg data 30 Nentor.

4-Neni 7 tregon qartë se si PP, që kanë investuar në ndërtimin e hidrocentraleve janë qartësisht të diskriminuar nga pikëpamja e sigurisë juridike të investimeve dhe kërkojmë nga ERE që ta marrë në shqyrtim në mënyrë të vecantë këtë situatë, ku investitorët që të parët kanë riskuar duke investuar në një fushë të re trajtohen më keq se ata që kanë investuar më vonë.

5- Neni 10 i propozuar për garancinë e origjinës është e paqartë.

6- Nenet 12 dhe 13 mendojmë se duhet të qëndrojnë sic kanë qenë sepse ndryshimet në më së shumti janë në favor të palës Bleërëse.

Për të gjitha sa më sipër propozojmë që të realizohet nga ERE një seancë dëgjimore me palët e interesuara për të kuptuar qëllimet e ndryshimeve të propozuara dhe diskutuar në detaje për sa më sipër.

Bashkëngjitur do të gjeni disa komente në lidhje me pika të ndryshme të marrëveshjes së propozuar nga FTL .

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin shpresojmë në marrjen parasysh të vlerësimeve tona dhe kërkesës për zhvillimin e seancës dëgjimore.

Me konsideratë,
**SHOQATA "AREA"**
**Anita SHUSHKU**
(________________________)
Kryetare e Bordit Ekzekutiv

Adresa: Rruga e Elbasanit, Vila nr. 71, Tirane

Miratuar me Vendimin nr. 101, datë 23.06.2016 të Bordit të ERE-s, ndryshuar me Vendimin nr.147, date 30.09.2016, ndryshuar me Vendimin nr.12, date 23.01.2020

---

# ~~KONTRATË~~MARREVESHJE

## PËR ~~SHIT~~BLERJEN TË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET FTL SH.A DHE PRODHUESVE ME PËRPARËSI TE ENERGJISË ELEKTRIKE

Commented [U1]: ku ka qene problemi per te ndryshuar edhe titullin Kontrate ne Marreveshje?

~~E lidhur sot~~ Sot me datë ____/____/____/, nënshkruhet kjo marreveshje per blerjen e energjise elektrike midis paleve: ~~Tiranë, ndërmjet~~;

**Shoqërisë** __________, person juridik shqiptar, regjistruar ne _______________ me vendim nr.______________, me nr. NIPT-i ____________ me seli te shoqërisë ______________, përfaqësuar nga ____________ Zj/Z ________________, nee cileesinee e Shiteesit

~~me nr. NIPT i __________ me seli te shoqërisë _______________,~~ ketu e me poshtë e quajtur **"Shitësi"**, ~~përfaqësuar nga Zj/Z________________;~~

*Dhe*

**Furnizuesi i Tregut tee Liree FTL sh.a.**, Shoqëri Aksionere, regjistruar si person juridik ____________________ me seli ne adresën: rruga______________________Tirane, ketu e me poshtë e quajtur "Blerësi", përfaqësuar nga Zj./Z_______________;

BAZA LIGJORE:

- Ligji Nr.9901, datee 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqeritee tregtare", i ndryshuar
- Ligji Nr.43, datee 30.04.2015 "Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuar
- Ligji Nr.24, datee 23.03.2023 "Per nxitjen e perdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme".

Commented [U2]: Kontratat presente perbajne si baze ligjore vetem ligjin 43/2015 dhe ligjin 138/2013 . A eshte korrekte qe nje kontrate 15 vjecare te ndryshoje bazen ligjore sa here del nje ligj apo VKM e re? FTL mund te propozoje nje kontrate te re per cdo prodhues te ri por jo per ato ekzistues.

- Ligji Nr.125, datee 25.04.2013 "Per koncesionet dhe partneritetin publik privat", i ndryshuar

- Ligji Nr.9887, datee 10.03.2008 "Per mbrojtjen e te dhenave personale", i ndryshuar

- Vendim i Keshillit te Ministrave Nr.822, datee 07.10.2015 "Per miratimin e rregullave dhe procedurave te ndertimit te kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike, qe nuk jane objekt koncesioni", i ndryshuar

- Vendim i Keshillit te Ministrave Nr.349, datee 12.06.2018 "Per miratimin e masave mbeshtetese per nxitjen e perdorimit te energjise elektrike nga burimet e rinovueshme te diellit dhe eres dhe procedurat per perzgjedhjen e projekteve per perfitmin e tyre", i ndryshuar

- Vendim i Keshillit te Ministrave Nr.369, datee 26.04.2017 "Per miratimin e metodologjise per percaktimin e blerjes se energjise elektrike te prodhuar nga nga burimet e vogla te rinovueshme nga dielli dhe era".

- Vendim i Keshillit te Ministrave Nr.456, date 29.06.2022 "Per miratimin e kushteve per vendosjen e detyrimit te sherbimit publik, qe do te zbatohen ndaj te licensuarve ne sektorin e energjise elektrike, te cilet ushtrojne aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shperndarjes dhe furnizmit me energji elektrike", i ndryshuar

**Duke qene se:**

~~Shoqëria~~ A. Shitesi ___________, ka marrë me koncesion/eshte mbajtes i miratimit perkates/ ka privatizuar, HEC-in/et ___________, sipas ~~marrëveshjes~~ kontrates se koncesionit/ sipas kontrates per ndertim/ rehabilitim, shfrytezim dhe administrim/transferim te impiantit prodhues/sipas kontratës se shitjes se pasurise se paluajtshme~~blerjes~~_______________;

Commented [U3]: E shikojme si jo relevante dy emertimet e fundit

- B. Ligji Per nxitjen e perdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme dhe Vendimi i Keshillit te Ministrave per miratimin e kushteve per vendosjen e detyrimit te sherbimit publik, qe do te zbatohen ndaj te licensuarve ne sektorin e energjise elektrike, te cilet ushtrojne aktivitetin e prodhimit,

transmetimit, shperndarjes dhe furnizmit me energji elektrike, detyrojne Bleresin te bleje energjine elektrike, te gjeneruar nga prodhues, subjekte te skemes mbeshtetese, ne perputhje me kete marreveshje tip, te miratuar nga Enti Rregullator i Energjise per nje periudhe jo me shume se ajo e percaktuar ne legjislacionin ne fuqi.

**Commented [U4]:** VKM per vendsjen e detyrimit te sherbimit publik ishte nje mase e perkoheshme dhe nuk k apse te jete ne kete marreveshje afatgjate kur ne fakt kjo VKM ehste ne kundershtim me kontraten e koncensionit dhe u pranua nga prodhuesit vetem sin je force majore.

- C Shitesi eshte licensuar nga ERE me Vendimin nr. ________, date ________ nee veprimtarine e prodhimit teenergjise elektrike nga impianti prodhues:

  - ________________ me kapacitet te instaluar __________;

  - ________________ me kapacitet te instaluar __________;

  - ________________ me kapacitet te instaluar __________;

me kapacitet total te instaluar __________.

D. Shtesi ka perfunduar punimet per ndertimin dhe venien ne operim te impiantit prodhues ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, ka shprehur vullnetin te shese energjine elektrike te prodhuar dhe ka plotesuar te gjithe dokumentacionin e detyrueshem juridiko-teknik te percaktuar nga Bleresi, me vendim teorganeve kompeteente vendimmarreese.

**Commented [U5]:** Mundti mos I kete perfunduar punimet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi por ne perputhje me legjislacionin qe ka qene ne fuqi ne Kohen kur jane kryer punimet. Nuk mund te ndryshojne kushtet cdo here qe del nje ligj apo VKM e re.

E. Shitesi eshte regjistruar si pjesemarres i Tregut te Energjise Elektrike.

**Commented [U6]:** Kusht I ri per prodhuesit ekzistente

F. Cmimi i shitjes se energjise elektrike per prodhuesit me perparesi te energjise sipas ligjit per nxitjen eperdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme percaktohet nga ERE.

Per sa me siper palet me vullnet lire vendosen te nenshkruajne kete marreveshje me kushtet e meposhtme:

**Commented [U7]:** Gjithmone kur eshte kjo fjale prezumon mungesen e vullnetit te lire ne fakt . Ne kontratat bashkohore eshte hequr plotesisht si koncept ne kontratat dypaleshe.

~~Palët janë përgjegjëse për përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj kontrate;~~

~~ERE me vendim te saj nr.__________, date __________, ka licencuar Shoqërinë __________ për prodhimin e Energjisë Elektrike; nga HEC/et ______ siç përcaktuar ne licencën e dhëne nga ERE.~~

FTL sh.a. i cili është i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë duhet te nënshkruajë një kontrate për blerjen e Energjisë Elektrike me Prodhuesit me Përparësi te Energjisë Elektrike ne zbatim te nenit 11 pika 2 te VKM nr. 244 date 30.03.2016 "*Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit te shërbimit publik, qe do te zbatohen ndaj te licencuarve ne sektorin e energjisë elektrike, te cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike*", ndryshuar me anee tee VKM see nr.883, datee 27.12.2019, nee nenin 11, pika 2 ku sanksionohet "Detyrimi i sherbimit publik per blerjen e energjise elektrike nga burimet e rinovueshme te energjise i vendoset shoqerise publike te **Furnizimit ne Tregun e Liree ne perputhje me legjislacionin nefuqi dhe kontrten tip, te miratuar nga ERE**

ERE ka autoritetin te përcaktoje çmimin e shitjes se Energjisë Elektrike për Prodhuesit me Përparësi te Energjisë Elektrike sipas nenit 15 pika 3 te ligjit nr. 138/2013 "Për burimet e rinovueshme".

Palët bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

**Përkufizime**

Në këtë kontratëPer qellimet e kesaj marreveshje, fjalet dhe termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet e percaktuara ketu. Sipas kontekstit te marreveshjes, perkufizimet mundte perdoren ne njejes, shumes, ne gjinine mashkullore apo femerore: si vijon:

1.1 Perkufizimet – termat e perdorur ne kete marreveshje do te kene kuptimin e percaktuar ne ligjin nr.43, date 30.04.2015 Per sektorin e energjise elektrike", i ndryshuarLigji Nr.24, datee 23.03.2023 "Per nxitjen e perdorimit te energjise nga burimet e rinovueshme", Vendim i Keshillit te Ministrave Nr.456, date 29.06.2022 "Per miratimin e kushteve per vendosjen e detyrimit te sherbimit publik, qe do te zbatohen ndaj te licensuarve ne sektorin e energjise elektrike, te cilet ushtrojne aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shperndarjes dhe furnizmit me energji elektrike", i ndryshuar dhe aktet e tjera nenligjore.

1.2 **Çmimi** - do të thotëeshte çmimi i shit-blerjes së Energjisë Elektrike, i vendosurmiratuar nga Enti Rregullator i Energjisë sipas legjislacionit në fuqi.;

Commented [U8]: Cmimi vjetor

1.3 DitaDite - do te thotë një periudhe kohore prej 24 orëshe, e cila fillon ne orën 00.00 per cdo dite kalendarike dhe perfundon ne oren deri ne 2400.00 ne diten pasuese kalendarike. . Dite kalendarike eshte cdo dite e muajit, duke perfshire dhe fundjavat dhe festat.

1.4 Disponueshmeri teknike – nenkupton intervalin/periudhen kohore pergjate se ciles centrali prodhues eshte ie afte te gjeneroje dhe injektoje energji lektrike nesistemin elektro – energjitik dhe kapacitetin operacional pergjate ketij intervali. Disponueshmeria teknike perfshin edhe disponueshmerine e gjithe infrastruktures se shitesit deri ne piken e livrimit.

1.5 Energjia Elektrike - nënkupton energjinë elektrike aktive e transmetuar ose shpërndarë ne sistemin elektro-energjetik

**Energjia Elektrike** ose **Energjia** - nënkupton energjinë elektrike aktive dhe energjinë elektrike reaktive të transmetuar dhe të shpërndarë nga sistemi elektro-energjetik

1.6 **Energji Elektrike Aktive** – është fuqia aktive që gjenerohet apo kalon në një qark elektrik gjatë një intervali kohe dhe përcaktohet nga integrali i caktuar i fuqisë aktive në kufijtë e kohës. Njësia matëse e saj është wat-Orë ose shumëfisha të saj.

**Energji Elektrike Reaktive** - është integrali i caktuar me kufij kohe i Fuqisë reaktive matur ne njësi me volt-amper reaktive ore ose shumëfisha te saj.

1.7 Enti Rregullator i Energjisë/**ERE** - nenkupton autoritetin rregullator per energjine sic eshte percaktuar ne ligjin per sektorin e energjise dhe legjislacionin tjeter te zbatueshem. Enti Rregullator i Energjisë;

**Frekuenca** - numri i cikleve alternative të rrymës për sekondë, në të cilin funksionon sistemi elektroenergjetik;

1.8 **Forcë Madhore** - është një akt ose ngjarje ~~ose një akt~~ natyrore ~~ose~~ apo shoqërore ~~që ndodh në vend~~, si tërmetet, ciklonet, rrufetë, përmbytjet, shpërthimet vullkanike, zjarret, lufta, konfliktet e armatosura, kryengritjet, aktet terroriste apo ushtarake, ngjarje qe sjellin si pasoje mosfunksionimin e komunikimeve ose sistemeve kompjuterike te operatoreve perkates te rrjetit të cilat pengojnë ~~Palën/Palët kontraktuese~~e licensuarin të përmbushin detyrimet ~~përkatëse sipas kësaj Kontrate~~e tij sipas licences , si dhe akte ose ngjarje të tjera, të cilat janë jashtë kontrollit të ~~mundshëm të Palës/Palëve~~arsyeshem dhe nuk ndodhin për faj të tij/tyre dhe ~~Pala/Palët~~i licensuari nuk ka pasur mundesi ti shmange nje akt ose ngjarje te tille nepermjet ushtrimit te vullnetit , ~~është/janë në gjendje t'i eliminoje ato, edhe pse ka/ne ushtruar siç duhet aftësitë~~aftësive, ~~përpjekjet~~ përpjekjeve dhe ~~kujdesin~~ kujdesit te tij te arsyeshem~~/tyre~~.

**Commented [U9]:** Konfliktet e armatosura jane ushtarake

1.9 Garancia e origjines- eshte nje dokument elektronik, i cili ka funksion te vetem qe ti provoje konsumatorit perfundimtar se nje pjese ose e gjithe sasia e dhene e energjise eshte prodhuar prej burimeve te rinivueshme.

**Commented [U10]:** Eshte nje garanci qe jepet nga nje autoritet perkates qe garanton se nje sasi energjie eshte e prodhuar nga nje central I caktuar . duke u nisur nga kjo konsumatoret mund te zgjedhin burimin nga I cili duan ta blejne energjine. Mendojme qe perkufizimi nuk eshte I sakte sepse kjo eshte nje terminologji nderkombetare dhe nuk mund te jete ndryshe per Shqiperine.

1.10 Grupi i balancimit – nje grup i perbere prej dy ose me shume paleve pergjegjese balancuese ne tregun e energjise elektrike, qe per qellim te balancimit, bashkojne skedulet e tyre dhe matjet nga pikat matese duke transferuar pergjegjesine e tyre te balancimit te lideri i grupit te balancimit duke vepruar si pale e vetme pergjegjese balancuese per shlyerjen e disbalancave.

1.11 Marreveshje blerje energjie – eshte nje lloj marreveshje per mbeshtjetje per shitblerjen e energjise lekltrike e lidhur midis PP dhe FTL, sipas te ciles bleresi garanton blerjen fizike te detyrueshme te energjise elektrike te gjeneruar nga prodhuesit me nje cmim fiks.

**Commented [U11]:** Nje marreveshje mbeshtetese lidhur midis FTL dhe PP ne zbatim te kontrates se koncensionit dhe kontratave jo koncensionare te lidhura midis investitoreve dhe MIE

1.12 **Matës** – eshte pajisja kryesore dhe / ose rezerve e certifikuar nga autoriteti kompetent perkates, e instaluar ne impiant për te matur dhe regjistruar sasite e Energjisë Elektrike te prodhuar nga impianti dhe te livruar ne piken matese.

1.13 **Muaji** - nenkupton periudhen kohore e cila fillon ne orën 00.00. te ditës se pare kalendarike te muajit dhe mbaron ne orën 24.00 te ditës se fundit kalendarike te po atij muaji;

**Commented [U12]:** Mungon viti si perkufizim

1.14 Operatori i Rjetit – eshte operatori i sistemit te transmetimit dhe / ose operatori i sistemit te shperndarjes.

~~Defektet në pajisjet ose materialet ose vonesat për ti bërë ato të disponueshme, konfliktet e punës, grevat ose problemet financiare nuk mund të kërkohet të konsiderohen nga Palët si Forcë Madhore, përveç rastit kur burojnë nga një rrethanë e lidhur me Forcën Madhore.~~

1.15 **OSSH~~EE~~** - është personi juridik i licencuar përgjegjes per operimin e sigurte, te besueshëm, dhe te efektshem te rrjetit te shpërndarjes duke siguruar mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit te shpërndarjes te shtrire ne një zone te caktuar dhe kur është e aplikueshme lidhjen e tij me sisteme te tjera e te siguruar aftësi afatgjate te sistemit për te përmbushur kërkesat e arsyeshme për shpërndarjen e energjisë, ne harmoni me mjedisin dhe eficenen e energjisë.

1.16 OST - është personi juridik përgjegjes per operimin, mirembajtjen dhe zhvillimin e sisitemit te transmetimit duke perfshire interkonjeksionet me sistemet e tjera nderkufitare, per tesiguruar aftesine afatgjate te sistemit per plotesimin e kerkesave te arsyeshme per transmetimin e energjise elektrike. ~~i cili është i ngarkuar me detyrimin i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë ne zbatim te nenit 11 pika 2 te VKM-se nr. 244 date 30.03.2016 *"Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit te shërbimit publik, qe do te zbatohen ndaj te licensuarve ne sektorin e energjisë elektrike, te cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit transmetimi, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"*.~~

1.17 **Palë** - **Shitësi** dhe **Blerësi** në këtë kontratë;

Commented [U13]: Marreveshje

1.18 **Pale pergjegjese per balancimin** – eshte nje pjesemarres i tregut te energjiseelektrike ose perfaqesues i zgjedhur prej tij , pergjegjes perballe OST per disbalancat e krijuara gjate operimit.

1.19 Pagese per prodhimin e nominuar – eshte pagesa bazuar ne vlerat e nominuara dhe te pranuara te programit te prodhimit, ne perputhje me rregullat e balancimit ne fuqi, ne rastin kur shitesi nuk eshte pjese e grupit te balancimit te bleresit.

1.20 **Pikë Lëvrimi** - eshte nje pike e sistemit elektro-energjitik e pajisur me nje ose me shume matesa ku behet livrimi i energjise elektrike ne rrjet, e percaktuar ne lejen e miratuar te lidhjes dhe ne marreveshjen e lidhjes. Ne rast se nuk eshte percaktuar, pika e livrimit do te jete pika e lidhjes se impiantit prodhues me sistemin energjitik.

**1.21Pikë Matje-** është Pika ne te cilën Sistemi i Matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE për këtë qëllim;

1.22**Prodhuesit me përparësi** - janë prodhuesit e energjisë elektrike nga burime te rinovueshme te energjisë elektrike, qe perfiton nga nje skeme mbeshtetese, sipas përcaktimeve te ligjit për nxitjen e perdorimit te ~~energjitë~~ energjisë nga burimet e rinovueshme ~~te energjisë elektrike~~.

1.23 Prodhimi i matur – nenkupton sasine e Energjisë Elektrike te gjeneruar nga impianti per cdo periudhe te shlyerjes se disbalancave te matur nga operatori i rrjetit, ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem.

1.24 Program – nenkupton teresine e veprimeve te nevojshme te paleve per kryerjen e detyrimeve perkatese te livrimit ose pranimit , qe mund te perfshijne nominimin, programimin, njoftimin, kerkimin dhe konfirmimin sipas gjithe rregullave te zbatueshme te tregut te miratuara nga ERE.

~~**Kontrata** - kjo kontratë e nënshkruar për shitblerjen e Energjisë Elektrike, e lidhur midis Prodhuesit me përparësi te Energjisë (Shitësit) dhe FTL sh.a (Blerësit) si dhe çdo shtesë apo amendim që mund t'i bëhet asaj në të ardhmen, me konsensusin e plaeve pas miratimit te ERE;~~

~~**Ligj** - Ligji nr. 43/2015 "Për sektorin e Energjisë Elektrike", ligji 138/2013 "Për burimet e energjisë se~~

**Commented [U14]:** Nga prodhuesi. Po sikur te dyja ta kene te ndryshme ? mendojme qe duhet te jete e percaktuar te marreveshja e lidhjes si dokumenti perfundimtar

**Commented [U15]:** Ky perkufizim eshte jo korrekt ne mendimin tone.

| | |
|---|---|
| | rinovueshme"; Ligji "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", te ndryshuar. |
| Matës | - d.m.th. një pajisje për matjen dhe regjistrimin e vlerave të matura të Energjisë Elektrike. |
| Muaji | - do te thotë periudha kohore e cila fillon ne orën 00.00 p.d. te ditës se pare kalendarike te muajit dhe mbaron ne orën 24.00 te ditës se fundit kalendarike te po atij muaji; |
| Palë | - **Shitësi** dhe **Blerësi** në këtë kontratë; |
| Pikë Lëvrimi | - Për efekt të kësaj kontrate, pika e livrimit do të jete nje pike e sistemit elektro-energjitik e percaktuar ne lejen e miratuar te lidhjes dhe ne marreveshjen e lidhjes. |
| Pikë Matje | - është Pika e Livrimit ne te cilën Sistemi i Matjes plotëson të gjitha kushtet teknike dhe të saktësisë sipas Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ERE për këtë qëllim; |
| 1.25 **Sistemi i Matjes së Energjisë Elektrike** ose **Sistemi i Matjes** | - është tërësia e pajisjeve te matjes se energjise elektrike si matesiësi, automati, transformatorët e rrymës dhe tensionit,, matësit dhe izolatorët, qarqet dhe pajisjet e ruajtjes, së të dhënave, pajisjet e transmetimit dhe të komunikimit të të dhënave dhe lidhjet e nevojshme kabllore, të cilat janë pjesë e pajisjeve të matjeve të Energjisë Elektrike Aktive dhe Energjisë Elektrike Reaktive në objektetj; |
| Viti | - do te thotë periudha kohore e cila fillon ne orën 00.00 te ditës se pare te vitit kalendarik dhe mbaron ne orën 24.00 te ditës se fundit te po atij viti kalendarik. |

1.26 Skeme Mbeshtetese – eshte instrumenti ose mekanizmi i aplikuar , qe nxit perdorimin e energjise nga burimet e rinovueshme.

**Commented [U16]:** qe mbeshtet nxitjen ....

**Neni 2**

**~~Qëllimi i Kontratës~~Objekti i marreveshjes**

Kjo ~~Kontratë~~ marreveshje rregullon marredheniet midis paleve per blerjen, shitjen, livrimin dhe pranimin e sasise se ~~përcakton termat dhe kushtet në të cilat Blerësi do të jetë i detyruar te blejë, dhe Shitësi do te jete i detyruar te shesë te gjithë~~ Energjinë Elektrike te prodhuar nga Shitësi si Prodhues me Përparësi i Energjisë Elektrike, ne përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi për kete qëllim.

**Neni 3**

**Livrimi dhe~~,~~ Pranimi ~~dhe Transferimi i të Drejtave~~i Energjisë Elektrike**

~~1~~ 3.1 Shitësi, ne përputhje me kete **marreveshje**~~kontrate~~ duhet të programojë, të prodhoje e të shesë dhe Blerësi duhet të programojë, të pranoje dhe te blejë ~~te gjithë~~ sasinë e prodhuar ose te programuar te Energjisë Elektrike në Pikën e Livrimit. Shitesi ka te drejte te shese energjine elektrike te prodhuar nga impianti prodhues ne treg te lire, ne perputhje me percaktmet e nenit 5.

~~2 Shitësi është i detyruar të marrë masat e duhura te lidhe impiantin prodhues te Energjisë Elektrike me Pikën e Lidhjes të përcaktuar, sipas specifikimeve dhe rregullave të përcaktuara ne Kodin e Shpërndarjes, Kodin e Matjes dhe akteve te tjera.~~

3.2 Energjia Elektrike do të transmetohet nga Shitësi tek Blerësi në Pikën e Livrimit, ~~ku dhe~~ne te cilen pronësia e Energjisë ~~do të kalojë~~kalon nga Shitësi tek Blerësi.

**Commented [U17]:** Cfare qellimi ka kjo pike?

~~4 Blerësi do t'i paguajë Shitësit sasinë e blerë të Energjisë Elektrike me çmimin e kontratës dhe sipas rregullave te përcaktuara ne nenin 8 (faturimi dhe pagesa).~~

~~5~~ 3.3 Blerësi ~~bie dakord që~~do të pranojë sasine ~~të tjera shtesë të~~e Energjisë Elektrike ~~nga ana e Shitësit, në rast~~ të ~~një~~ ~~prodhimi~~ prodhuar ose programuar ~~më të madh nga ky i fundit. Për këtë~~nga Shitësi, me perjashtim ~~duhet~~ të rasteve te depozitimit te nje qendrimi ndryshe nga organet kompetente. ~~bëjë njoftimet përkatëse për ti mundësuar Blerësit marrjen e Energjisë si dhe rregullimin e programit~~ të tij.

**Commented [U18]:** Kjo duhet saktesuar se per ke behet fjale sepse per PP qe jane pjese e grupit te balancimit te FTL, FTL do te pranoje te gjithe prodhimin, ndersa per ato qe jane jashte grupit te balancimit te FTL, ...

6 "Pavarësisht detyrimit qe ka FTL për te blere te gjithë energjinë elektrike te prodhuar nga shitësi, shitësi ka te drejte te shesë te gjithë ose pjese te energjisë se prodhuar subjekteve te tjerë te ndryshëm nga FTL, ne sasitë dhe mënyrat e zgjedhura nga vete shitësi". Grafiku i lëvrimit për energjinë qe do te shitet ne tregun e pa rregulluar do te jete ne bande sipas profilit 00:00 - 24:00.

## Neni 4

**Dokumentacioni Paraprak, Tensioni, FrekuencaProgramet elivrimit dhe remontet**

144.1 Shitësi do t`i vereі vendos ne dispozicion/dorëzoje Blerësit te gjithë dokumentacionin parashikimet dhe programet e prodhimit ne terma afatgjate dhe afat shkurter dhe siguron bleresin qe jane ne perputhje me praktikat me te mira te industrise dhe legjislacionit te zbatueshem. dhënat lidhur me testimet dhe transmetimin e Energjisë, specifikimet teknike te gjithë pajisjeve elektrike te instaluara përfshire ketu edhe certifikatat especifikimeve, detajet e matëseve dhe pajisjeve te sigurisë te instaluara, 30 dite përpara se impianti prodhues te vihet ne shfrytëzim te plote e te filloje prodhim/livrimin e Energjisë.

144.2 Shitësi i vendos ne dispozicion Blerësit parashikimet dhe programet e prodhimit si vijon:

a) jo me vone se data 1 (nje) Gusht te vitit aktual, parashikimin vjetor me baza mujore te prodhimit te energjise elektrike per vitin pasardhes

b) jo me vone se 1 (nje) jave para fillimitte secilit muaj, parashikimin mujor te prodhimit te energjise elektrike

c) jo me vone se cdo dite te merkure te seciles jave pasardhese, parashikimin javor te prodhimit te energjise elektrike

Shitesi per cdo ndryshim nga parashikimet e mesiperme duhet te njoftoje Bleresin ne perputhje me Kodet e Rrjetit dhe rregullat perkatese.

4.3 Shitesi qe ka perzgjedhur te jete pjese e grupit balancues te bleresit duhet te deklaroje programin e prodhimit per cdo periudhe te shlyerjes se disbalancave, per

**Commented [U19]:** Afrimi I dates se parashikimit vjetor nga 30 Nentor ne 1 Gusht ul saktesine e parashikimit te prodhimit per vitin pasardhes. Deri ne fund te Nentorit shikohet me sakte se si eshte prodhimi I vitit aktual qe ndihmon ne parashikimin e vitit pasardhes ne menyre te vecante per hecet ku viti hidrologjik ehste Tetor-Tetor.

diten ne avance D + 1 bazuar ne Rregullat e Tregut Shqiptar te Balancimit te Energjisë Elektrike dhe kushtet e marreveshjes se sherbimit te balancimit.

4.3.1 Shitesi qe nuk ka deklaruar programin e prodhimit ne perputhje me piken 3 te ketij neni, duhet te njoftoje bleresin jo me vone se ora 09:00 a.m te dites D-1, per diten D,per disponueshmerine teknike (nese ka kufizime) te impiantit prodhues sipas Aneksit pjese integrale te kesaj marreveshje, si dhe programin e remonteve apo nderhyrjeve te tjera te cilat mund te impaktojne prodhimin e energjise elektrike. Cdo ndryshim ne disponueshmerine teknike te impiantit prodhues, duhet ti njoftohet menjehere Bleresit.

4.3.2 Nè rast se pjesemarresi i grupit te balancimit deshton ne dergimin e programit / skedulit te prodhimit te energjise elektrike, atehere parashikimi i programit per pjesemarrjen e grupit te balancimit do te behet nga lideri i grupit te balancimit te Bleresit.

4.3.3 Per te mundesuar nje planifikim sa me cilesor dhe me qellim reduktimin e kostove te disbalancave, shitesi, pjese e grupit balancues te bleresit dhe/ose operatori perkastes i rrjetit, duhet qe ti japin akses te plote bleresit ne sistemin e telematjes, stacionet meteorologjike si dhe ne cfare do instalimi tjeter ne impiantin prodhues, per ti mundesuar bleresit qe te kryeje parashikimet e duhura ne lidhje me prodhimin e prithsem te impiantit prodhues.

4.4 Shitesi, qe ka perzgjedhur te mos jete pjese e grupit balancues te bleresit, duhetti deklaroje bleresit, brenda ores 09:00 a.m te Dites D-1 , per diten D, programin e prodhimit per cdo periudhe shlyerje te disbalancave, bazuar ne Rregullat e Tregut Shqiptar te Balancimit te energjise elektrike.

4.4.1 Bleresi nuk do te pranoje asnje program te ri apo te ndryshuar per diten D, ne D-1 dhe ne D, diten ne avance apo brenda te njejtes dite, te deklaruar pas afatit te mesiperm, perfshire dhe pa u limituar ne ndonje program te derguar ne afatet kohore tw tregut te energjise elektrike brenda se njejtes dite.

4.4.2 Ne rast se shitesi nuk do ti deklaroje Bleresit programin e dites ne avance, sipas percaktimeve te pikes 4.4 programi qe do te konsiderohet i nominuar dhe mbi t e cilin Operatori i Sitemit te Transmetimit do te perllogarise disbalancat do te jete 0 (zero).

4.5 Shitesi i vendos ne dispozicion bleresit programin e remonteve apo nderhyrjeve te tjera te miratuara nga operatoret e rrjetit te cilat mund te impaktojne prodhimin e energjise elektrike.

~~Energjia Elektrike duhet të livrohet me tension dhe frekuencë ne përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore ne fuqi.~~

**Neni 5**

**~~Programet e Livrimit~~Shitja e energjise ne treg te lire**

~~1~~5.1. Shitesi ka ~~Impiantet prodhues me fuqi te instaluar mbi 5 MW duhet~~ te drejte ~~programojnë dhe~~ te tregtoje te gjithe energjine e prodhuar nga impianti gjenerues ne tregun e lire, me kusht qe: ~~paraqesin tek Blerësi programet e lëvrimit ne përputhje me Rregullat e Tregut te Energjisë Elektrike.~~

- brenda dates 1 (nje) gusht te vitit aktual , te informoje Bleresin se e gjithe energjia e prodhuar per vitin pasardhes do te tregtohet ne tregun e lire;

-periudha minimale gjate se ciles Shitesi mund te shese energjine elektrike ne tregune lire eshte 1 (nje) vit;

- nuk do te jete pjese e grupit te balancimit te bleresit, per periudhen e tregtimit ne tregun e lire.

5.2 Brenda dates 1 (nje) gusht te vitit ne te cilin shitesi shet ne treg te lire, duhet te njoftoje bleresin per vijimesine e shitjes ne treg te lire per vitin pasardhes. Ne rast se shitesi nuk njofton per vijimesine, konsiderohet qe energjia qe do te prodhohet prej tij i shitet Bleresit.

5.3 Tregtimi i energjise elektrike te prodhuar nga impianti gjenerues ne tregun e lire, sipas parashikimeve te ketij neni, nuk pezullon afatin e kesaj marreveshje.

~~2. Impiantet prodhues me fuqi nen 5 MW do te paraqesin programin mujor/vjetor sipas sasisë se Energjisë Elektrike qe parashikohet te prodhohet.~~

~~3. "Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga FTL impiantet prodhues duhet te deklarojnë programet e tyre te livrimit dhe kontratat përkatëse për ditën ne avance", si dhe planifikimin vjetor ku përcakton sasinë e energjisë elektrike qe shitësi do te~~

**Commented [U20]:** PP do ta kene te veshtire te marrin nje vendim per te dale ne treg te lire para dates 1 Gusht derisa cmimi I mbeshtetjes nga ERE per vititn n+1 del ne fund te Dhjetorit dhe bazohet ne cmimin mesatar te vitit n. Prandaj AREA mendon qe te mos ndryshoje informimi per daljen ne treg me afat final 30 Nentor.

shes ne FTL sh.a., dhe ne tregun e pa rregulluar te energjisë elektrike. Ky planifikim dërgohet ne FTL sh.a. brenda datës 30 Nëntor te vitit aktual për vitin pasardhës. Nominimi i programit përkatës do te behet ne përputhje me rregullat e tregut te energjisë elektrike.

4. Kur blerësi është subjekt i ndryshëm nga FTL, ndaj impianteve prodhues zbatohen Rregullat e Tregut mbi Disballancat, sipas parashikimeve të legjislacionit ne fuqi"".

5. Devijimet nga programet e paraqitura do te trajtohen ne përputhje me Rregullat e Tregut te Energjisë Elektrike apo çdo akti tjetër te miratuar nga ERE-ja për kete qellim.

**Neni 6**
**Matja e Energjisë Elektrike të Livruar**

6.1. Matja e Energjisë Elektrike të livruar nga Shitësi te Blerësi do të kryhet nga operatori perkates i rrjetit në Pikën e Matjes/Livrimit, e cila do te jete ne pronësi te Shitësit, konform rregullave të përcaktuara në Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike dhe/ose ne aktet e tjera te aplikueshme.. Për përcaktimin e instalimit, mirëmbajtjes, kontrollit, testimit dhe vulosjes së Sistemit të Matjes të Energjisë Elektrike, Palët i referohen Kodit të Matjes së Energjisë Elektrike.

6.2 Matesi i Energjisë Elektrike duhet te jete i afte te realizoje matje ne intervalet kohore te percaktuara ne rregullat e aplikueshme te balancimit.

6.3 Matesi i Energjisë Elektrike duhet te jete i afte te komunikoje me sistemin qendror te menaxhimit te operatorit perkates te rrjetit.

6.4 Elementet e sigurise se sistemit te matjes se energjise elektrike bashkevendosen nga operatori perkates i rrjetit dhe Bleresi.

